

VENDIM
Nr. 636, datë 27.8.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës “A”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, ndryshohen të dhënat për 5 (pesë) individë, të renditur në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

**NDRYSHIME NË LISTËN E INDIVIDËVE TË SHPALLUR ANËTARË OSE
BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT**

**SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
(LISTA E OKB-së)**

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

a) Ndryshime në “Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”.

1: *HAMDULLAH: NOMANI*

2: *ABDUL-HAQ: WASSIQ*

3: *NOOR MOHAMMAD: SAQIB*

4: *SIRAJUDDIN: JALLALOUDINE: HAQQANI*

5: *GUL: AGHA: ISHAKZAI*

Shënim. Gjenealogjet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.